



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes :	71041-02182-11-2016	Data e Regjistrimit :	13/12/2016
Numri i Vendimit:	11-2017-48	Data e Vendimit :	12/01/2017

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Fejzo Hysi

SEKRETARE: Vasilika Fuqi

Sot më datë 12/01/2017mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues {...}

Objekti:Heqjen e sekuestros preventive të vendosur me vendim nr.436 datë 08.07.2015 dhe nr.436/1 datë 27.07.2015 të Gjykatës së Shakallës së parë Durrës.

Baza Ligjore:Neni 274/3 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi administroj aktet që i bashkëngjiten fashikullit të gjykimit, dëgjoji **përfaqësuesen e kërkuesit** që kërkoj të pranohet kërkesa sipas objektit të saj.

Përfaqësuesin e akuzës, **prokuror Afrim Shehu** i cili deklaroi se ne jemi shprehur për heqjen e sekuestro preventive në vendimin e pushimit të çështjes dhe jemi për pranimin e kërkesës të kërkuesit.

VEREN :

Vëren:

Se! Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës mbi bazën e referimit të kryer nga policia gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Qarku Durrës, ka regjistruar procedimin penal nr. 237 të vitit 2010, rifilluar me datë 28.05.2012 për veprën penale "Pastrim i produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287. 1, germa " a , b" të Kodit Penal.

Mbi këtë bazë prej saj është kërkuar të vendoset sekuestro preventive mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të kërkuarit {...}.

Gjykata e rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e saj Nr.436/1 Datë 27.07.2015 ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

• **Vendosjen e sekuestro preventive të pasurisë së paluajtshme si më poshtë:**

- a. Pasuria nr. 3/61+2-G2, Vol.77, Fq.236, ZK.8518, Garazh me sip.31.95 m2, në pronësi të {...} i dtl.{...}.
- b. Pasuria nr. 3/61+2-G4, Vol.77, Fq.238, ZK.8518, Garazh me sip.29.16 m2, në pronësi të {...} i dtl.{...}.
- c. Pasuria nr. 3/61+2-G7, Vol.77, Fq.241, ZK.8518, Garazh me sip.29.47 m2, në pronësi të {...}, i dtl.{...}.
- d. Pasuria nr. 3/61+2-N1, Vol.77, Fq.248, ZK.8518, Njësi me sip.212.3 m2, në pronësi të {...} i dtl.{...}.
- e. Pasuria nr. 3/61+2-1, Vol.79, Fq.01, ZK.8518, Apartament me sip.108.13 m2, në pronësi të {...}i dtl.{...}.
- f. Pasuria nr. 3/61+2-N3, Vol.79, Fq.04, ZK.8518, Njësia me sip.112.4m2, në pronësi të {...}, i dtl.{...}.
- g. Pasuria nr. 3/61+2-4, Vol.79, Fq.06, ZK.8518, Apartament me sip.99.8 m2, në pronësi të {...}, i dtl.{...}.
- h. Pasuria nr. 3/61+2-13, Vol.79, Fq.15, ZK.8518, Apartament me sip.76.6 m2, në pronësi të {...}, i dtl.{...}.
- i. Pasuria nr. 3/61+2-19, Vol.79, Fq.21, ZK.8518, Apartament me sip.76.6 m2, në pronësi të {...}, i dtl.{...}.
- j. Pasuria nr. 3/61+2-25, Vol.79, Fq.27, ZK.8518, Apartament me sip.76.6 m2, në pronësi të {...} i dtl.{...}.
- k. Pasuria nr. 3/61+2-26, Vol.79, Fq.28, ZK.8518, Apartament me sip.74.27 m2, në pronësi të {...}, i dtl.{...}.
- l. Pasuria nr. 3/61+2-N3, Vol.82, Fq.27, ZK.8518, Njësi me sip.61.9 m2, në pronësi të {...}, i dtl.{...}.
- m. Pasuria nr. 3/61+2-N5, Vol.82, Fq.28, ZK.8518, Njësi me sip.44.27 m2, në pronësi të {...}, i dtl.{...}.

Pala kërkuese në kërkesën drejtuar gjykatës argumenton se:

Me vendim të datës 25.11.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur, Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 237 Viti 2012 për veprën penale të " Pastrim të produkteve të veprës penale " parashikuar sipas nenit 287/1 germa " a dhe b " të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit {...} si dhe në bazë të nenit 261/1 germa " a " të K.Pr.Penale

urdhëron heqjen e masës sigurimit "Sekuestro preventive" të vendosur me vendim nr. 436 dhe 436/1 datë 08.07.2015 e datë 27.07.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës dhe urdhëron ZVRPP Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Kërkuesi argumenton se ky vendim i marrë nga organi i akuzës nuk është zbatuar nga ZVRPPP Durrës me pretendimin se është gjykata që ka marrë vendimin e sekuestro dhe i përket po këtij institucioni të vendos heqjen ose jo të sekuestro preventive mbi këtë pasuri në emër të kërkuarit.

Gjykata pasi administroi dosjen gjyqësore me nr. 436 të vendimit datë 08.07.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës, vendimin nr.431/1 të datës 27.07.2015, vendimin e datës 25.11.2015 të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës që ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 237 viti 2012, arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuarit është e bazuar në ligj dhe prova dhe si e tillë duhet të pranohet duke urdhëruar heqjen e sekuestro preventive pranë ZVRPP Durrës të dhënë po nga kjo gjykatë me vendimin Nr. 436 datë 08.07.2015 dhe nr. 436/1 datë 27.07.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës.

Për këto arsye

Baza Ligjore: Gjykata bazuar në 274/3 të K.Pr.Penale .

VENDOSI:

Vendosi:

Pranimin e kërkesës së të kërkuarit {...} dhe urdhëron Z.V.P.P Durrës , për heqjen e sekuestro preventive mbi pasurinë e luajtshme dhe të pa luajtshme të dhënë me vendimin Nr. 436 datë 08.07.2015 dhe vendim nr. 436/1 datë 27.07.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të pushimit të procedimit penal Nr. 237 Viti 2012, në ngarkim të kërkuarit për akuzën e nenit 287/1 germa "a" e "b" të Kodit Penal.

-Dosja penale me nr. 436 datë 08.07.2015 si dhe nr.436/1 të datës 27.07.2015 të dorëzohet në arkiv të gjykatës.

-Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës.

-U shpall në Durrës më datë 12.01.2017

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	200
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	200

GJYQTAR:

Fejzo Hysi